



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 1600 prot.

Elbasan, më 20.06.2024

**U D H Ë Z I M**

**Mbi zhvillimin e procesit të votimit për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**

Mbështetur në Urdhrin nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë", në Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UE

**U D H Ë Z O N**

1. Votimet për autoritete drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatin Akademik të UE-së zhvillohen në një ditë të vetme, në datën e caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.
2. Administratori i UE duhet të japi mbështetjen e tyre që në mjediset ku do të ngrihen qendrat e votimit, të ketë një vend hyrje dhe një vend dalje për votuesit.
3. Në mjediset përreth qendrave të votimit është e ndaluar rreptësisht prezenca e materialeve të fushatës zgjedhore nga secili kandidat garues.
4. Administratori dhe KZF janë përgjegjës për garantimin e standardeve zgjedhore.
5. Në mjediset e Njësive kryesore gjatë ditës së zgjedhjeve është e ndaluar kategorikisht fushata në mbështetje të kandidatëve garues. Personeli i administrimit në njësinë kryesore ë UE-së, duhet të marrë masat e nevojshme , në komunikim me KZF e njësisë ku po zhvillohet procesi i votimit.
6. Qendra e votimit hapet në orën 8.00 dhe mbyllet zyrtarisht në orën 16.00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari, ka ende votues që presin në radhë, mblidhen mjetet e tyre të identifikimit dhe procesi përfundon pasi edhe këta të fundit, të kenë votuar.
7. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë fshehtësinë e votës. Në qendrën e votimit është e ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit.
8. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen nga një anëtar i komisionit. Pasi hyn në qendrën e votimit zgjedhësi thotë emrin e tij, nëse është personel akademik apo student, njësinë bazë ku bën

pjesë dhe paraqitet fizikisht para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të idenditetit me të dhëna biometrike:

- Letërnjoftim
- Pasaportë

9. Kryetari, pasi verifikon se të dhënat e idenditetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të idenditetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.
10. Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij.
11. Zgjedhësit personel akademik, i jepet për të votuar fletët e votimit për:

- i. Rektor
- ii. Drejtues i njësisë kryesore (Dekan)
- iii. Përgjegjës departamenti në të cilin bën pjesë
- iv. Fleta e votimit për anëtarë të personelit akademik në senatin Akademik.

**Zgjedhësit-personel akademik në të gjithë njësitë kryesore të UE-së duhet të shënojnë jo më shumë se 4 (katër) emra kandidatësh, sa është numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik**

12. Zgjedhësit student i jepen për të votuar fletët e votimit për:

- i. Rektor
- ii. Drejtues të njësisë kryesore
- iii. Anëtarë të Senatit Akademik përfaqësues i studentëve. Zgjedhësi student duhet të shënojë jo më shumë se 2 (dy) emra kandidatësh sa është numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik që i përkasin kategorisë së studentëve.

13. Në rast të zgjedhjes të më shumë emrave se sa numri përkatës i mandateve në Senatin Akademik, fleta e votimit bëhet e pavlefshme.

14. Çdo fletë votimi vuloset, në pjesën e pasme me vulën e KZF.

15. Pasi merr fletën e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:

- i. Në fletën e votimit për Rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësisë bazë, shënon krahas emrit të kandidatit shenjën “X” ose “+” ose √. Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetëm një kandidat zgjedhësi voton një nga alternativat e shkruajtura krahas emrit të kandidatit “Pro” “Kundër”
- ii. Në fletën e votimit për anëtarë të Senatit Akademik shënon, shenjën “X” ose “+” ose √.
- iii. Pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që vula të jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët e votimit në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

16. Nëse shënimin në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i KZF e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët “E dëmtuar” dhe e fut në zarfin “Fletë votimi të dëmtuara”. Dhe zgjedhësit nuk i jepet fletë votimi.

17. Në qendrën e votimit ndalohet kategorikisht përdorimi i aparateve celularë apo mjeteve të tjera regjistruese. Votuesi duhet të hyjë në dhomën e fshehtë i pa ngarkuar me çanta, mjete, sende, qoftë edhe shkollore.

18. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit lejohen të qëndrojnë vetëm:

- i. Anëtarët dhe sekretari i KZF

- ii. Zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundimin e tyre
  - iii. Vëzhguesit e akredituar nga KIZ
  - iv. Anëtarët e KIZ që monitorojnë procesin zgjedhor
  - v. Përfaqësues të MAS në rast se paraqiten.
19. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm komisioni merr vendimin për mbylljen e votimit. Pas kësaj në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF-së si dhe vëzhguesit e akredituar dhe kandidatët.
20. Ditën e votimit nga ora 7.00 deri në orën 24.00 në Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ndalohet prania e personave të paautorizuar në mjediset e brendshme të qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj, në korridoret e brendshme të ndërtesës ku është / janë vendosur qendrat e votimit dhe perreth tyre në një distancë rrethore me rreze jo më pak 150 m. Në rast se konstatohet prani e personave të paautorizuar KZF njofton menjëherë KIZ dhe Administratorin.
21. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Florenc Pilgriu

Anëtar: Armela Mazrreku

Anëtar: Mustafa Kadzadej

Anëtar: Julian Çota

Anëtar: Behije Gollobërda

Anëtar: Marsel Sulanjaku

Anëtar: Klodjana Maloku